



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 27 mars 2019

Numri i lëndës: 2017-02

Zufe Miladinović

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 27 mars 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar më 19 prill 2017.
2. Me shkresën e datës 20 prill 2017, Paneli ka njoftuar Misionin për regjistrimin e kësaj lënde në Panel.
3. Më 12 prill 2018, Paneli ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shfes së Misionit (ShM) të EULEX-it Kosovë.
4. Më 22 maj 2018, ShM-ja ka dorëzuar përgjigjet e saja në Panel.
5. Më 10 janar 2019, parashtresat e ShM-së iu dërguan parashtrueses së ankesës për komente. Ankuesja ishte ftuar të parashtronte parashtrës shtesë, nëse kishte, më së voni deri më 4 shkurt 2019. Ankuesja kërkoi më shumë kohë për t'u përgjigjur dhe për të

dhënë informacion shtesë për Panelin. Ajo u përgjigj më 6 mars 2019. Në letrën e saj, ankuesja tregoi se ajo qëndronte pranë ankesës së saj, duke vënë në dukje ato çfarë ajo i sheh si kontradikta në parashtrësitë e ShM-së dhe kërkon që ankesa të shpallet e pranueshme.

6. Pas dorëheqjes së fundit të një anëtarit të përhershëm, Paneli do të mbledhet në këtë çështje vetëm me dy anëtarë në përputhje me rregullat 11 dhe 14 të rregullores së punës së Panelit.

I. FAKTET

7. Faktet e paraqitura nga ankuesja mund të përmblihen si më poshtë.
8. Ankuesja është bashkëshortja e z. Srboljub Miladinović.
9. Ankuesja deklaroi se më 25 qershor 1998, z. Srboljub Miladinović ishte larguar nga shtëpia e tyre në Reçan në komunën e Prizrenit për të udhëtuar me autobus për në Prishtinë. Autobusi ishte ndaluar pranë fshatit Carralevë nga persona të armatosur. Z. Miladinović ishte nxjerrë nga autobusi nën kërcënimin e forcës. Personat e armatosur ishin përpjekur të merrnin një person tjetër, V.I., me vete, por një grua në autobus kishte intervenuar dhe i kishte ndalë ata që ta merrnin V.I.
10. Ankuesja më vonë kishte mësuar nga V.I. se ata që e morën burrin e saj mendohej të ishin anëtarë të UÇK-së dhe se bashkëshortit të saj iu ishin mbyllur sytë dhe ishte lidhur para se të dërgohej në drejtim të Malishevës.
11. Në një raport të Njësisë së UNMIK-ut për Hetimin e Krimeve të Luftës (WCIU) të datës 9 dhjetor 2004, të dhënë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), doli që bashkëshorti i ankueses mund të ishte qëlluar gjatë rrëmbimit, përderisa përpjeqej të arratisesh, por se ai i kishte mbijetuar të shtënave.
12. Pas rrëmbimit të bashkëshortit të saj, ankuesja kishte kërkuar për të në gjithë Kosovën pa sukses. Në një moment në dhjetor 1998, ajo u përpoq të vizitonte një vend ku të burgosurit serbë pretendohet se ishin mbajtur peng, por pohon se asaj i është ndaluar hyrja në atë vend nga kreu i OSBE-së, Misioni i Verifikimit të Kosovës dhe stafi i tij. Dikur më vonë, ankuesja dëgjoji nga një person i panjohur se bashkëshorti i saj ishte lidhur në një pemë në një fshat afër Lipjanit dhe pastaj ishte vrarë.
13. Ankuesi raportoi rrëmbimin dhe zhdukjen e bashkëshortit të saj në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë, OSBE, në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY) në Beograd dhe në Kryqin e Kuq Jugosllav. Përveç kësaj, ankuesja i bashkëngjiti ankesës së saj një raport penal drejtuar Prokurorit Ndërkombëtar të Prokurorisë Publike të Qarkut, Prizren.
14. Më 9 shtator 1998, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) hapi një kërkesë për ta kërkuar z. Miladinović. Emri i tij gjithashtu u paraqit në një listë të personave të zhdukur, të komunikuar nga KNKK-ja tek Policia e UNMIK-ut më 12 tetor 2001 dhe në një bazë të të dhënave të përpiluar nga Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (OMPF). Në listën në internet të personave të zhdukur që mbahet nga Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur 3 (ICMP3) në lidhje me z. Miladinović në pjesët përkatëse shkruan si vijon: "Janë mbledhur mostra të mjaftueshme referimi" dhe "Nuk është gjetur përputhje me ADN-në".

15. Ankuesja pohon se autoritetet nuk kanë bërë asgjë efektive për të gjetur bashkëshortin e saj për më shumë se dhjetë vjet pasi ai është zhdukur.
16. Ankuesja ka parashtruar një ankesë pranë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) të UNMIK-ut më 7 prill 2009. PKDNj-ja ka dhënë mendimin e vet më 1 shtator 2013 dhe në atë vendim shkruan si në vijim:

"Paneli (PSDNj-ja) thekson që zhdukjet e imponuara dhe ekzekutimet arbitrare përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut, të cilat do të hetohen dhe ndiqen në të gjitha rrethanat. Paneli gjithashtu thekson që UNMIK-u si administrues territorial i Kosovës nga viti 1999 deri më 2008, kishte përgjegjësinë primare t'i hetojë në mënyrë efektive dhe t'i ndjekë ata që ishin përgjegjës për vrasje, rrëmbime apo zhdukje në rrethana kërcënimi me jetë. Dështimi për ta bërë këtë, paraqet shkelje të mëtejme serioze të të drejtave të viktimave dhe më të afërmeve të tyre, në veçanti të së drejtës për ta ditur të vërtetën për çështjen.

Paneli thekson shqetësimet e PSSP-së që burimet joadekuate, veçanërisht në fillim të misionit të UNMIK-ut, e bënë të vështirë arritjen e plotësisht të obligimeve të UNMIK-ut për të drejtat e njeriut. Do të ishte normale që UNMIK-u t'i marrë masat e duhura me qëllim që t'i ndalë shkeljet e theksuara dhe t'i korrigjojë atë sa është e mundur me efektet nga kjo. Megjithatë, siç ka theksuar Paneli më lart (shih § 18), përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me administrimin e drejtësisë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen përsipër nga EULEX-i të kontrollit të plotë operacional në fushën e zbatimit të ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozitë të marrë masa që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në hetime që ende janë në zhvillim e sipër para EULEX-it apo autoriteteve vendore.

Gjithashtu pas shpalljes së pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës, më 17 shkurt 2008 dhe më pas, hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u ka pushuar së kryeri funksione ekzekutive në Kosovë, dhe ky fakt kufizoi aftësinë e tij për të siguruar korrigjim të plotë dhe efektiv të shkeljeve të kryera, siç kërkohet me parimet e vendosura në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut".

17. PKDNj-ja ka përfunduar, *ndër të tjera*, si vijon:

"Konstaton se ka pasur shkelje të obligimit procedural sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Konstaton se ka pasur shkelje të obligimit esencial sipas nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Rekomandon që UNMIK-u të kërkojë nga EULEX-i dhe autoritetet e tjera kompetente në Kosovë të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm për të siguruar që hetimi penal për zhdukjen e z. Srboljub Miladinović të vazhdojë në përputhje me nenin 2 të KEDNj-së dhe që autorët të sillen para drejtësisë".

18. Në një datë të mëvonshme, ankuesja ka pranuar një letër nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP-ja) si në vijim:

"Pas shqyrtimit të mendimit dhe rekomandimeve të Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut lidhur me ankesën e znj. Zufe Milladinovic (lënda nr. 86/09), më datën 13 nëntor 2013 kam njoftuar Panelin tim këshillëdhënës për si në vijim:

Që në fillim dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për punën e Panelit dhe për rekomandimet e dhëna lidhur me ankesën në fjalë.

Lidhur me rekomandimin e parë, ashtu siç është rekomanduar nga Paneli, UNMIK-u do të vazhdojë të nxisë EULEX-in dhe autoritetet e tjera kompetente që të vazhdojnë të ndërmarrin të gjithë hapat e mundshëm për t'u siguruar që hetimet penale lidhur me zhdukjen e bashkëshortit të ankueses të vazhdohen dhe që kryerësit e krimeve të vihen para drejtësisë.

Lidhur me rekomandimin e dytë të Panelit, më vjen keq për mungesën e hetimit të efektshëm lidhur me zhdukjen e bashkëshortit të ankueses, gjë e cila gjithashtu ka shkaktuar shqetësim dhe vuajtje mendore.

Paneli gjithashtu ka rekomanduar që unë të ndërmarr hapa të duhur lidhur me pagesën e kompensimit për ankuesin lidhur me dëmin moral, si dhe të ndërmarrë hapa të duhur për realizimin e programit të plotë dhe gjithëpërfshirës të reparacioneve. Në këtë drejtim, dëshiroj të përkujtoj se veprimet në fjalë kanë të bëjnë me aktivitetet e institucioneve të themeluara në kuadër të administratës së përkohshme të Kosovës. Si të tilla, po qe se UNMIK-u edhe sot do të vazhdonte të ketë kontroll ndaj këtyre institucioneve, do të kishte qenë në pozitë që t'ia referojë rekomandimet e Panelit këtyre institucioneve në mënyrë që ato të ndërmarrin veprimet e duhura. Unë jam i gatshëm të diskutoj mundësinë e themelimit të mekanizmit për trajtimin e këtyre çështjeve me autoritetet përkatëse në rrethanat e duhura.

Në fund, përkitazi me rekomandimin e pestë lidhur me garancitë për mospërsëritje, dëshiroj të theksoj se UNMIK-u më nuk zbaton funksione policore, duke përfshirë edhe hetimet policore. Në këtë drejtim, dëshiron të përkujtoj se Paneli është themeluar nga UNMIK-u me mandat për të shqyrtuar ankesat nga cilido person a grup i individëve që pretendojnë se kanë qenë viktimë e shkeljeve të të drejtave të tyre të njeriut nga ana e UNMIK-ut. Unë gjithashtu dëshiroj të përkujtoj se mandati i UNMIK-ut dhe, rrjedhimisht, mandati i PSSP-së, është i kufizuar në atë që parashihet në Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, ashtu siç ka ndryshuar me kalimin e kohës sipas rrethanave të përcaktuara nga Këshilli i Sigurimit.

Thënë në përgjithësi, Panelin mund ta informojmë se organet kryesore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kanë miratuar rezoluta dhe vendime të shumta, përmes të cilave pasqyrohet rëndësia e avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe mbrojtjen e tyre nga Kombet Bashkuara. Organizata gjithashtu vazhdon të bëjë ndryshime me qëllim të fuqizimit të punës së saj për të ardhmen dhe brenda fushëveprimit të Organizatës Kombeve të Bashkuara, ku mund të bëjë ndryshime. Në këtë aspekt, do të vazhdojë përpjekjet e veta në plotësimin e misionit të vet për mbrojtjen e njerëzve nga dëmi".

19. Në një datë të pasaktësuar më pas, ankuesja e ka adresuar çështjen në EULEX. Ajo u informua nga EULEX-i se akuza penale e regjistruar në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës ishte hedhur poshtë për shkak të mungesës së provave në lidhje me autorët. Ajo u informua më tutje nga EULEX se rasti do të mbetej aktiv derisa të vërtetohej fati i bashkëshortit të saj.

II. ANKESA

20. Ankuesja i referohet dy të drejtave themelore të caktuara të pasqyruara në dispozitat e mëposhtme: Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), nën drejtimin e tij procedural, i cili garanton të drejtën themelore të njeriut për jetën dhe siguron për një detyrim për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta; Neni 3 i Konventës, i cili garanton të drejtën e personit për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose poshtëruës. Artikulli 8 dhe 13 i Konventës dhe të drejtat e garantuara në bazë të tij gjithashtu duket se kanë lidhje të mundshme me këtë rast. Të njëjtat të drejta themelore të njeriut garantohen nga një numër i traktateve të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Këto të drejta janë pjesë e një grupi thelbësor të të drejtave themelore të njeriut, të cilat janë të garantuara për të gjithë si një çështje e së drejtës ndërkombëtare zakone.
21. Duke marrë parasysh marrëdhënien e ngushtë familjar ndërmjet viktimës së drejtpërdrejtë dhe ankueses, Paneli është i bindur që ankuesja mund të konsiderohet si një viktimë dytësore e shkeljeve të supozuara dhe se si e tillë viktimë e mundshme në pajtim me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

III. PARASHTRIMET E PALËVE NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË

Ankuesi

22. Siç përmbledhet më lartë, ankuesja pretendon se EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv duhej të kishte hetuar zhdukjen e bashkëshortit të saj dhe me fajin e vet nuk e ka bërë atë në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe të bashkëshortit të saj.

Shefi i Misionit (“ShM”)

23. Përgjigjja e ShM-së është dërguar në Panel më 22 maj 2018. Nga përgjigjja duket qartë çfarë paraqitet si në vijim.
24. ShM-ja pohon se dosja që ka të bëjë me zhdukjen e viktimës ishte ofruar nga UNMIK-u tek EULEX-i diku nga fundi i vitit 2008 dhe fillimi i vitit 2009.
25. UNMIK-u që fillimisht kishte kryer një hetim të këtij rasti, kishte hapur një dosje të personave të zhdukur më 4 prill 2002. Një “raport hetimor Ante-Mortem” ishte parashtruar më pas nga ankuesi në këtë rast më 19 dhjetor 2004, duke treguar se UNMIK-u në një moment kishte biseduar me të.
26. Në një datë të pasaktësuar, ankuesja ka parashtruar një ‘Raport mbi akuzën penale ndaj kryesve të panjohur të veprave penale’ pranë Prokurorit Ndërkombëtar të Prokurorisë së Qarkut në Prizren.
27. Më 14 shtator 2008, rasti ishte rishikuar nga UNMIK-u dhe ishte përpiluar një ‘Raport i shqyrtimit të analizës së rastit’, duke treguar se rasti duhej të mbetej në pritje ‘duke pritur informacione të mëtejshme’.
28. Vlerësimi fillestar i lëndës nga një prokuror i EULEX-it është bërë më 6 mars 2009.

29. Më 20 korrik 2009, prokurori i EULEX-it ka lëshuar një 'Kërkesë për të kryer hetime'.
30. Më 11 janar 2011, Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës të EULEX-it (NjHKL) ka shqyrtuar përsëri lëndën.
31. Më 3 dhjetor 2013, një prokuror i EULEX-it në PSRK ka shqyrtuar përsëri dosjen e lëndës dhe ka lëshuar 'Refuzim të Raportit Penal' bazuar në pikëpamjen se nuk kishte asgjë në dosjen e lëndës që mund të sugjeronte veprime të mundshme hetimore'.
32. Më 1 dhjetor 2015, Misioni ka pranuar një letër nga ankuesi, të datës 1 nëntor 2015.
33. Më 22 dhjetor, Misioni iu është përgjigjur letrës së parashtrueses së ankesës dhe i ka ofruar asaj një kopje të 'Refuzimit të Raportit Penal'. Dokumenti nuk ishte dorëzuar me sukses. Dokumenti ishte ridërguar përmes zyrës së EULEX-it në Beograd dhe përfundimisht ishte dorëzuar më 31 dhjetor 2015.
34. Më 14 maj 2018, dosja e lëndës që lidhet me zhdukjen e z. Miladinović ishte transferuar në institucionet e Kosovës.
35. Dosja e lëndës e mbajtur nga EULEX-i nuk përmban asnjë indikacion se EULEX-i më tej kishte kontaktuar UNMIK-un pas marrjes së kësaj dosje. ShM-ja gjithashtu ka treguar se Misioni nuk ka kërkuar të kontaktojë ndonjë subjekt tjetër të përfshirë në këtë çështje (p.sh., KNKK-së, UNMIK-ut, etj.) me qëllim të marrjes së informacionit që mund të kenë në lidhje me këtë rast.
36. Nuk ka asnjë indikacion në të dhënat se Misioni ka kërkuar të kontaktojë ankuesen ose të afërmit e tjerë të viktimave gjatë hetimit të këtij rasti ose t'i mbante të informuar për këtë çështje. Misioni shpjegon se 'Refuzimi i Raportit Penal' nuk i ishte dorëzuar parashtrueses së ankesës për shkak të 'situatës politike' 'në atë kohë dhe se dorëzimi i dokumenteve me "Republikën e Kosovës" ishte *de facto* e pamundur në atë kohë.
37. Procesverbali nuk sugjeron që EULEX-i ka intervistuar ose ka kërkuar të intervistonte ndonjë dëshmitar (potencial) në lidhje me atë rast.
38. Megjithatë, ShM-ja parashtron se ankuesja nuk ka arritur t'i përmbahet afatit kohor prej 6 muajsh brenda të cilit ajo mund të parashtronte ankesë pranë Panelit. Duke u mbështetur në *aktgjykimin Varnava* të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), Misioni sugjeron që përderisa koha e marrë nga ankuesja për të paraqitur ankesën e tij në Panel mund të mos jetë "e tejkaluar" në bazë të vlerësimit të vënë nga GjDNj-ja, ajo mund të duket ende 'e paqartë' në bazë të atij vlerësimi. *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, Lënda nr. 16064/09 e tutje, Aktgjykim, 18 shtator 2009.
39. Së fundi, ShM-ja kërkon që nëse ankesa shpallet e pranueshme, asaj duhet t'i jepet mundësia për t'i adresuar meritat e çështjes.

IV. VLERËSIMI I PANELIT NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË

Mandati i Panelit (Rregulla 25 par. 1 i rregullores së punës) dhe kufizimet e qenësishme të vëna Misionit në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut

40. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor

2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet demokratike ligjore.

41. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do t'i pranoj ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës
42. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
43. Paneli tashmë ka vendosur se veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K deri T kundër EULEX-it*, 2013 *Krlić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, paragrafi 23, *Y kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, paragrafi 35). Ky është rasti i veprimeve pozitive ose i dështimeve të fajshme.
44. Gjithashtu duhet të theksohet për qëllimet e tanishme se të drejtat që i nënshtrohen kësaj ankese janë ndër të drejtat më të rëndësishme të të gjitha të drejtave themelore. Ato prekin interesat thelbësore të viktimave të supozuara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat. Praktika e zhdukjes me forcë përbën shkelje të madhe të këtyre të drejtave. Kjo reflektohet, *ndër të tjera*, në faktin se praktika e 'zhdukjes me forcë' tani konsiderohet dhe karakterizohet si krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (Statuti i Romës, neni 7(1)(i)) dhe në Ligjin mbi Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar (Ligji nr. 05/L-053) (Neni 13(1)(i)).
45. Të gjitha arsyet e lartpërmendura janë marrë parasysh gjatë marrjes së vendimit për pranueshmërinë e kësaj lënde.
46. Implikimet e ndryshimeve në mandatin e Misionit pas mbylljes së Misionit në qershor 2018 për qëllimin e këtij rasti do të adresohen, aty ku kur është e nevojshme, në vendimin e Panelit për meritat. Palët janë të ftuara për të adresuar këtë çështje nëse dëshirojnë të bëjnë parashtrës të mëtejshme në lidhje me meritat e kësaj çështjeje.

Kompetenca ratione temporis e Panelit

47. Siç është cekur më lart, ShM-ja pohon se Paneli nuk ka juridiksion *ratione temporis* lidhur me këtë rast. Në veçanti, ShM-ja pohon se ankuesja nuk ka arritur të përmbushë afatin 6 mujor të përcaktuar në nenin 25(3) të rregullores së punës së Panelit. Kjo dispozitë përcakton që 'ankesa(t) duhet të dorëzohet(n) në Panel brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së supozuar'. Shih, p.sh., *Gashi kundër EULEX-it*, 2013-22, 7 prill 2014, para. 10; *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2009, para. 51.
48. Paneli duhet të vendosë nëse lënda ishte e pranueshëm në kohën kur ishte parashtruar ankesa. Për arsyet e përshkruara më poshtë, Paneli është i bindur se ka qenë ashtu.
49. Si çështje paraprake, Paneli thekson që shkeljet e ankimuar konsiderohen si shkelje që janë duke vazhduar ose si shkelje të vazhdueshme të të drejtave themelore të viktimës. Shih D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për Pranueshmëri, 30 Shtator 2015, para. 78; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për Pranueshmëri, 29 shtator 2015, par. 35 dhe 42. Shih gjithashtu, në kontekstin e nenit 3, GJEDNJ, Kurt kundër Turqisë, vendimi i 25 majit 1998,

Raportet e Vendimeve dhe Vendimeve 1998 III, par. 130-34; Khadzhaliev dhe të tjerët kundër Rosisë, Kërkesa nr. 3013/04, aktgjykimi i 6 nëntorit 2008, par. 120-121; Timurtas kundër Turqisë, Aplikimi nr. 23531/94, Aktgjykimi i 13 qershorit 2000, para. 95; dhe Rezoluta nr. 828 e 1984, paragrafi 3 (Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës).

50. Së dyti, Paneli dëshiron të thotë në vijim lidhur me mbështetjen e Misionit në *lëndën Varnava* (GjEDNj). Së pari, Paneli qartas nuk obligohet sipas pikëpamjes së Gjykatës lidhur me interpretimin e pranueshmërisë së një çështjeje para Gjykatës. Pranueshmëria e një ankese pranë Panelit rregullohet nga rregullat dhe parimet e saj, të cilat dallojnë në disa aspekte nga ato që zbatohen nga Gjykata. Së dyti, pavarësisht dallimeve të tilla, pikëpamjet e Gjykatës mund të jenë relevante kur kërkesat e pranueshmërisë të zbatueshme nga Gjykata janë të krahasueshme me ato që zbatohen nga Paneli. Në këtë drejtim, autoriteti juridik i Gjykatës garanton që Paneli duhet të marrë në konsideratë pikëpamjet e Gjykatës përkundër faktit se nuk është i detyruar ta bëjë këtë. Së treti, afatet kohore të parashtruara për paraqitjen e një ankese pranë Gjykatës dhe Panelit kërkojnë të arrijnë të njëjtin qëllim përfundimtar: të garantojë që Gjykata/Paneli është në gjendje të ruajë efektivitetin e të drejtave të një ankuesi, ndërsa në të njëjtën kohë t'i shmang vonesat e panevojshme, të cilat mund të dëmtojnë këtë qëllim dhe të krijojnë gjendje të pasigurisë së përhershme ligjore. Afatet nuk janë të vendosura për të ndëshkuar ndonjë aplikant, as nuk duhet të interpretohen si vendosje e pritjeve të paarsyeshme mbi viktimat e shkeljeve serioze të të drejtave.
51. Duke u kthyer tek rasti i përmendur nga ShM-ja (*Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*), Paneli thekson si në vijim. Së pari, Gjykata sugjeron (paragrafi 162) se duhet të bëhet dallimi në pikën midis situatave të vdekjeve të paligjshme ose të dhunshme dhe rasteve të zhdukjes së detyrueshme, pasi në rastin e fundit ekziston një element i pasigurisë dhe jodijenisë për fatin e viktimës. Prandaj Gjykata thotë se "duhet të ketë masa për pasigurinë dhe konfuzionin që shpesh shënojnë pasojat e zhdukjes". Paneli është dakord. Gjykata më pas thotë se 'natyra serioze e zhdukjeve është e tillë që standardi i shpejtësisë që pritët nga të afërmit nuk mund të jetë shumë i rreptë në kontekstin e mbrojtjes së Konventës' (par. 163). Paneli është dakord.
52. Gjykata më pas ka vazhduar të thotë si në vijim (paragrafi 165):

"165. Megjithatë Gjykata konsideron se aplikacionet mund të refuzohen pasi bien jashtë afatit kohor në rastet e personave të zhdukur kur ka pasur vonesë të tepruar ose të pashpjeguar nga ana e aplikantëve sapo të kenë, apo duhej të kenë qenë të vetëdijshëm se nuk është ndërmarrë asnjë hetim ose që hetimi ka dështuar në mosveprim ose bëhet i paefektshëm dhe në asnjë prej këtyre rasteve, nuk ka asnjë shpresë të menjëhershme dhe realiste për një hetim efektiv se do të ofrohet në të ardhmen. Kur ekzistojnë iniciativa në lidhje me situatën e personave të zhdukur, aplikantët mund të presin në mënyrë të arsyeshme zhvillimet që mund të zgjidhin çështje kryesore faktike ose ligjore. Në të vërtetë, përdërisa ka një kontakt kuptimplotë mes familjeve dhe autoriteteve në lidhje me ankesat dhe kërkesat për informacion, ose ndonjë indikacion, apo mundësi reale lidhur me progresin rreth masave hetimore, në përgjithësi nuk lindin shqetësime për vonesa të panevojshme. Sidoqoftë aty ku ka kaluar një periudhë e gjatë kohore dhe ka pasur vonesa të mëdha dhe pezullime në aktivitetin hetimor, do të vijë një moment kur të afërmit duhet të kuptojnë se nuk ka pasur ose nuk do të ofrohet ndonjë hetim efektiv. Kur kjo fazë të arrihet do të varet në mënyrë të pashmangshme nga rrethanat e vet rastiit veç e veç".

Prandaj, Gjykata përcakton tre kushte dhe një kualifikim: (i) ndonjë vonesë e tepruar ose e pashpjegueshme; (ii) ndërjegjësim nga ana e viktimës se nuk ka pasur hetime ose se ai ishte ndërprerë nga mosveprimi/paafhtësia; (iii) nuk kishte asnjë shpresë të

menjëhershme dhe reale për një hetim efektiv që do të sigurohej në të ardhmen; (iv) kur ekzistojnë iniciativa në lidhje me situatën e zhdukjes, aplikuesit mund të presin në mënyrë të arsyeshme zhvillimet që mund të zgjidhin çështje kryesore faktike apo ligjore.

53. Duke marrë parasysh këtë çështje, Misioni nuk përmend paragrafin e fundit të asaj pjese të vendimit të Gjykatës (paragrafi 166), i cili është gjithashtu relevant dhe thotë:

“166. Në një situatë komplekse të zhdukjes siç është kjo që paraqitet në një situatë të konfliktit ndërkombëtar, ku thuhet se ekziston një mungesë e plotë e ndonjë hetimi apo kontakti kuptimplotë me autoritetet, mund të pritët që të afërmit të parashtrajnë rastin më së largu brenda disa viteve nga incidenti. Nëse ekziston një hetim i llojit, qoftë edhe sporadik i pllakosur me probleme, të afërmit mund të presin disa vite më shumë, derisa shpresa për progresin e bërë të jetë humbur në mënyrë efektive. Kur kanë kaluar më shumë se dhjetë vjet, në përgjithësi aplikantët duhet të tregojnë bindshëm se ka pasur disa përpertime të vazhdueshme dhe konkrete që janë arritur për të justifikuar vonesa të mëtejshme për të ardhur në Strasburg. Pritjet më të rrepta do të zbatoheshin në rastet kur aplikantët kanë qasje të drejtpërdrejtë vendore tek autoritetet hetimore”.

54. Prandaj perspektiva realiste e një hetimi është një pikë e rëndësishme në vlerësimin e kësaj pyetjeje siç është ilustruar, *ndër të tjera*, nga lëndë *Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës* përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në atë lëndë, bashkëshorti i aplikantit ishte zhdukur që nga viti 1995. Eshtrat e tij ishin zhvarrosën dhe ishin identifikuan katërmbëdhjetë vjet më vonë. Dy të dyshuar ishin identifikua, por iu ishin shmangur ndjekjen penale. Sa i përket afatit prej gjashtë muajsh, aktgjykimi e kishte dalluar lëndën e Varnava dhe të tjerëve, duke gjetur se znj. Palić ende mund të pres realisht që një hetim efektiv të kryhej kur ajo të paraqiste kërkesën e saj në vitin 2004, në mënyrë që ajo të vepronte në mënyrë të arsyeshme në përmbushjen e rregullit e afatit gjashtëmuajor. Shih *Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, par. 70.
55. Lidhur me këtë kusht të pranueshmërisë, Paneli do të vë në dukje parimet e mëposhtme, të cilat dalin nga juridiksioni i Panelit. Ankesat e paraqitura jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar nga rregullat në parim do të shpallen të papranueshme në përputhje me rregullën 29(c) të rregullores së punës. Shih *Mikic kundër EULEX-it*, 15 qershor 2015, par. 8-9; *K.P. kundër EULEX-it*, 21 prill 2015, par 15; *Martinovic kundër EULEX-it*, 23 nëntor 2011, par. 17-18. Sidoqoftë në disa raste Paneli ka ushtruar lirinë e vet për t'i shpallur ankesat të pranueshme, të cilat ishin parashtruar me vonesë, por kur rrethanat e veçanta që kanë të bëjnë me rastin justifikojnë që çështja të mos shpallet e papranueshme për ato arsye. Rëndësia e veçantë e shkeljes së pohuar ose besimi nga ana e ankuesit se çështja ishte ende duke u shqyrtuar nga Misioni janë konsideruar si veçanërisht relevante në këtë drejtim nga Paneli. Shih, p.sh. *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 29 shtator 2015, par. 44 e tutje; *D.W. dhe të tjerët kundër EULEX-it*, 30 shtator 2015, par. 91 e tutje. Për më tepër, Paneli ka konstatuar se nëse shkelja e të drejtave themelore është ende duke vazhduar, në parim afati prej 6 muajsh nuk ka kaluar përderisa shkelja të pushojë. Shih, për shembull, *Zahiti kundër EULEX-it*, 7 qershor 2013, paragrafi 42. Në një rast të tillë, afati fillon të zbatohet prej datës kur veprimi i ankimuar thuhet se ka shkaktuar ose ka rezultuar në shkelje të së drejtës. Shih, për shembull, *Y kundër EULEX-it*, 15 nëntor 2012, paragrafët 30-31. Duhet gjithashtu të kujtojmë në këtë kontekst se EULEX-i Kosovë është mision i sundimit të ligjit, e jo shtet, dhe se zbatimi i detyrimeve të të drejtave të njeriut përbën një element thelbësor dhe të domosdoshëm të misionit të tij (shih referencat e mësipërme).
56. Lidhur me zbatimin e parimeve dhe konsideratave të mësipërme në rastin në fjalë, Paneli thekson sa vijon. Ankesa është parashtruar në Panel më 19 prill 2017. Kjo ishte përfaqësisht 16 muaj pasi që ankueses i ishte dërguar një kopje e 'Refuzimit të Raportit

Penal' nga Misioni. Megjithatë, 'Refuzimi' nuk i dha fund përgjegjësisë së Misionit për të hetuar këtë rast. Kjo përgjegjësi zgjati më së paku deri më 14 maj 2018 kur dosja e lëndës që lidhet me zhdukjen e z. Miladinovic ishte transferuar në institucionet e Kosovës. Deri në atë pikë, Misioni ishte kompetent për të hetuar këtë rast. Kjo duket qartë nga fakti se Misioni ka informuar ankuesen se rasti do të vazhdonte të ishte aktiv deri në momentin që mund të vërtetohej fati i viktimës (shih, më sipër, paragrafi 19). Misioni nuk e ka informuar ankuesen se më nuk ishte kompetent për hetimin e këtij rasti dhe se në fakt kishte pasur kompetencë për ta bërë këtë deri në fund të mandatit të tij ekzekutiv.

57. Paneli gjithashtu thekson që sipas OPLAN-it të rishikuar, siç pasqyrohet në rregullën 25(4) të rregullores së punës së Panelit, ankesat lidhur me rastet e transferuara nga EULEX-i në institucionet e Kosovës do të parashtrohen brenda gjashtë muajve nga përfundimi i mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale siç përcaktohet në ligjin e Kosovës ose brenda gjashtë muajve nga transferimi i dosjes së lëndës. Duke pasur parasysh se ky rast është transferuar më 14 maj 2018, afati i fundit për paraqitjen e ankesës nuk kishte skaduar ende në kohën e paraqitjes së kësaj ankese.
58. Gjithashtu relevante është fakti se, që nga zhdukja e z. Miladinovic, ankuesja kishte marrë disa hapa për të kërkuar informacion rreth fatit të tij nga autoritetet e ndryshme që ajo mendonte se mund të ishin kompetentë ose mund të kishin informacione për fatin e bashkëshortit të saj. Ajo kurrë nuk ka hequr dorë, pavarësisht faktit se rasti kishte shkuar nga një autoritet në tjetrin gjatë gjithë kohës (UNMIK-i, EULEX-i, autoritetet vendore). Rrjedhimisht, vështirë se mund të thuhet që ankuesi ishte joaktiv ose se vonesat ishin të pashpjegueshme.
59. Për më tepër, vonesa në parashtrimin e ankesës siç pretendohet nga Misioni nuk ka shkaktuar ndonjë dëm për sa i përket procedurave pranë Panelit. Interesi që Misioni mund të ketë në zbatimin e rreptë të afatit 6 muor duhet që gjithashtu të interpretohet në atë kuptim.
60. Paneli gjithashtu thekson mungesën e përpjekjeve nga ana e Misionit për të informuar ankuesen rreth rrjedhës së këtij hetimi. "Refuzimi" ishte dërguar vetëm në përgjigje të nismës nga vetë ankuesja. Ankuesja nuk duket se ka qenë e informuar për secilin aspekt të rishikimit dhe hetimit të Misionit lidhur me këtë rast. Për më tepër, në dokumentin "Refuzimi" asgjë nuk ka sugjeruar që Misioni do të pushonte së provuari ta sqaronte këtë çështje, meqë me të vërtetë pritej të bëhej sipas kushteve të zbatueshme të OPLAN-it të atëhershëm.
61. Prandaj, duke shikuar edhe një herë në *aktgjykimin Varnava*, vonesa e llogaritur ndaj ankuesja nuk mund të thuhet se është e tepruar ose e padefinuar, pasi ankuesja kishte vazhduar të nxiste dhe të kontaktonte ato autoritete, të cilat ajo mendonte se mund t'i ndihmonin në lëvizjen përpara të këtij hetimi. Siç është cekur nga Gjykata Evropiane,

"[...] ekziston një lloj hetimi, qoftë edhe nëse është sporadik dhe i pllakosur me probleme, të afërmit mund të presin me arsye disa vite më shumë derisa shpresa për përparim të zhduket në mënyrë efektive".

Është e qartë se ankuesja kurrë nuk e ka humbur atë shpresë dhe se ajo i ka vazhduar përpjekjet e saja me të gjitha ato autoritete, të cilat ajo ka menduar se mund ta ndihmonin të zbulonte se çfarë i kishte ndodhur bashkëshortit të saj.
62. Në këto rrethana, Paneli është i bindur se ankuesja ka vepruar me zell dhe se afati prej 6 muajsh i përcaktuar në rregullat në këtë rast është përmbushur.

63. Paneli thekson se *ratione temporis* është kompetent të shqyrtojë veprimet e Misionit deri më 14 qershor 2018. Pas kësaj date, Misioni ka pushuar të ketë ndonjë përgjegjësi ekzekutive në lidhje me atë rast. Megjithatë aktivitetet e kryera pas kësaj date mund të jenë relevante për të vlerësuar masën në të cilën mund të thuhet se Misioni ka përmbushur detyrimet e veta ndaj të drejtave të njeriut. Rrjedhimisht, Paneli fton Misionin që t'i referohet parashtrimeve të veta lidhur me çfarëdo përpjekje të ndërmarrë nga Misioni për të siguruar që ky rast ishte ose është duke u hetuar (nëse ka), përfshirë edhe pas kësaj date.

Kompetenca e Panelit ratione materiae

64. ShM-ja nuk e kundërshton kompetencën *ratione materiae* të Panelit, dhe Paneli është i bindur që në këtë çështje është kompetent *ratione materiae*.

Kompetenca e Panelit ratione personae

65. ShM-ja nuk e kundërshton kompetencën *ratione personae* të Panelit për këtë ankesë. Siç shihet nga çfarë u tha më lartë, Paneli me të vërtetë është i bindur që ka kompetencë *ratione personae* mbi këtë çështje.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

SHPLL TË PRANUESHME ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pa paragjykuar meritat e çështjes;

KËRKON NGA PALËT QË T'IU PËRGJIGJEN PYETJEVE VIJUESE si pjesë e parashtrësive të tyre mbi meritat e këtij rasti, pa paragjykuar pikëpamjet dhe konkluzionet e Panelit:

i. Për Misionin:

- a. Para datës 3 dhjetor 2013 dhe "Refuzimit të Raportit Penal", çfarë hapi hetues kishte marrë Misioni për të sqaruar këtë rast? A ishin të informuar të afërmit e personave të zhdukur për këto përpjekje?
- b. A është ndërmarrë ndonjë hap për të hetuar këtë rast apo për të mbledhur informacion pas kësaj date?
- c. Pas pranimit të një letre nga ankuesi më 1 dhjetor 2015, a ka ndërmarrë ndonjë hap Misioni për të hetuar këtë rast? Nëse po, çfarë hapi(a)?
- d. Gjatë transferimit të dosjes së lëndës në institucionet e Kosovës, a ishte dërguar ndonjë material hetues tek autoritetet vendore në lidhje me këtë rast? A ishte informuar ankuesi për këtë transferim?
- e. A është duke e monitoruar Misioni këtë rast?

ii. Për ankuesen:

- a. A jeni në dijeni për ndonjë përpjekje nga autoritet vendore (të Kosovës) për të hetuar këtë rast?
- b. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankueses sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
- c. Cilat janë pasojat personale, financiare dhe emocionale – që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?

KËRKON NGA PALËT që të paraqesin çfarëdo parashtrese lidhur me meritat e këtij rasti jo më vonë se me datën 20 maj 2019 ose nëse nevojitet më shumë kohë, të bëhet një kërkesë me kohë në mënyrë që të zgjatet afati deri në atë datë.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues



Anna BEDNAREK
Anëtar